

KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Sesioni 2, Grupi i Punës I (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)

Tema: Negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe eksperiencia rajonale – Kapitulli 23 në fokus

5 shkurt 2021

Zhvillimet e fundit

- Reformimi i Sistemit Gjyqësor si një nga prioritetet e vendosura dhe nga Komisioni Europian është një proces që ka filluar që në 2015 e po vazhdon.
- Kjo reformë ka ndryshuar 1/3 e Kushtetutës shqiptare dhe është pasuar nga një kornizë ligjore e përbërë nga 27 ligje dhe nga aktet nënligjore në zbatim të tyre, duke ridimensionuar tërësisht fytyrën e gjyqësorit shqiptar.
- Procesi i rivlerësimit të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i vetingut) vazhdon, ku sot janë vlerësuar më shumë se 286 dosje nga një total prej rreth 800 të tilla, prej të cilave 62% janë përkthyer në heqje nga detyra, ku një nga arsyet më të shpeshta është mos justifikimi i pasurisë.
- Gjithashtu, në kuadër të reformës në drejtësi janë ngritur strukturat e specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si Prokuroria e Posaçme; Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Gjykatat e Posaçme
- Lufta kundër korrupsionit – është një tjetër nga prioritetet kyçe dhe një ndër komponentët kryesorë të kapitullit 23. Për këtë është krijuar Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit, si një mekanizëm i përbërë nga profesionistë të rinj e me integritet, të cilët do të angazhohen fuqimisht për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e çdo indicieje të rasteve të dyshuara si korruptive, për ta përcjellë më pas për shqyrtim sipas rastit në strukturat e specializuara të Ministrisë së Drejtësisë ose Prokurorisë së Posaçme.

- Sipas vlerësimit të Komisionit Europian në raportin e Shqipërisë për vitin 2020 sa i përket Kapitullit 23 Shqipëria ka një nivel të moderuar përgatitje dhe gjatë 2019 ka bërë progres të mirë
- Një zhvillim tjetër është dhe përditësimi i strategjisë për Drejtësinë 2017-2020 dhe planit të saj të Veprimit, si dhe ngritja e strukturës koordinuese që mbështet zbatimin e reformave në këtë kapitull koordinuar nga Ministria e Drejtësisë.
- Në kuadër të procesit screening më 27-28 shtator 2018 është zhvilluar takimi shpjegues për kapitullin 23, ku delegacioni shqiptar u njoh me aktet ligjore dhe politikat kryesore të Bashkimit Europian lidhur me të drejtat e njeriut dhe me parametrat themelore të një sistemi gjyqësor efektiv
- Ndërkohë që është ngritur Tryeza e Këshillimit dhe Diskutimit për Kapitullin 23, si pjesë e Platformës së Partneritetit për të përfshirë aktorët e shoqërisë civile, ekspertë, akademikë, komunitetin e biznesit dhe përfaqësues të pushtetit vendor në procesin e negociatave për Kapitullin 23 që koordinohet nga MD.

Rekomandimet

- Është i nevojshëm funksionimi i plotë i strukturave të sistemit gjyqësor dhe strukturave speciale të ngritura kundër korrupsionit. Gjithashtu janë të nevojshme burimet e duhura financiare dhe njerëzore për këto struktura. Bashkëpunimi me entitetet gjyqësore të tjera duhet të forcohet.
- Të vazhdojnë përpjekjet për rekrutimin e magistratëve të rinj të cilët duhet të përmbushin kriteret dhe standardet e transparencës, pavarësisë dhe përgjegjshmërisë, duke mos lënë mënjanë aftësitë profesionale të tyre. Procesi i rivlerësimit të magistratëve duhet të vazhdojë më me shpejtësi dhe me eficiencë.
- Lufta kundër korrupsionit duhet të vazhdojë ku në fokus duhet të jetë gjurmueshmëria dhe një historik i plotë dhe i saktë i rasteve të korrupsionit.

- Procesi i integritimit europian nënkupton europianizimin e shtetit që bëhet anëtar i BE-së, dhe vendi së bashku më të gjithë rajonin ka ende nevojë për tu europianizuar. Qëllimet kryesore lidhen së pari me paqen, që nuk mund të ndahet nga demokracia, drejtësia, të drejtat e njeriut dhe siguria që janë pjesë thelbësore e Kapitullit 23. Ky mision nuk është plotësuar ende, dhe duhet që përpjekjet të vazhdojnë për arritjen e këtij qëllimi që do të kulmonte me europianizimin e vendit dhe anëtarësimin të tij në BE.
- Duhet pasur parasysh që në këtë proces parimet themelore mbeten të pandryshuara, edhe pse procedura dhe forma e arritjes e përmbushjes së tyre mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin. Për këtë të gjitha reformat që merren duhet të kenë parasysh përmbushjen e këtyre parimeve që janë themelore për Bashkimin Europian.
- Për tu anëtarësuar në BE, duhet të ketë në radhë të parë përgatitje nga shteti shqiptar dhe pjekuri. Procesi duhet të ketë një kombinim të ambicieve, por të jetë edhe realist. Pra procesi të matet mirë, por motivimi për të arritur hapin e atyre vendeve që janë para nesh apo dhe atyre që janë pjesë e BE-së duhet të jetë pjesë e gjithë punës dhe reformave.
- Mbështetja e qytetarëve është shumë e nevojshme gjatë gjithë procesit, sidomos kur ai shoqërohet me reforma që ndonjëherë janë transformuese dhe 'të dhimbshme' për disa grupe apo sektorë të shoqërisë. Për këtë duhet që qytetarët të informohen dhe të përfshihen dhe të jenë të qartë që përfitimet janë më shumë se kostot në këtë proces. Konsensusi i të gjithë shoqërisë është në fakt fillimi i anëtarësimin në BE.
- Procesi duhet të ketë një kombinim të reformave në vend, por edhe bashkëpunimin dhe fqinjësisë së mirë me rajonin, me vendet e tjera të Ballkanit perëndimor. Pasi nuk mund të ketë progres në procesin e anëtarësimin nëse nuk ka marrëdhënie të mira me ata që do të jenë vende partnere në BE gjithashtu.
- Marrja dhe zbatimi i reformave është kyç për progresin e mëtejshëm, dhe për këtë duhet kohë dhe shumë punë e përfshirje nga të gjithë sektorët dhe aktorët e shoqërisë. Sugjerohet gjithashtu nga eksperti sllovak që duhet marrë kohë dhe masa tranzitore për ato çështje të cilat janë më të ndërlikuara dhe të ndjeshme që kanë nevojë për më shumë vëmendje dhe kohë për tu plotësuar. Për këtë pra është e rëndësishme që procesi të karakterizohet nga realizmi dhe objektivizimi.

- Bashkëpunimi me institucionet e Bashkimit European është thelbësor gjithashtu, si me Komisionin, Parlamentin dhe Presidencat e Këshillit.
- Procesi duhet të jetë i besueshëm, dhe të gjitha strukturat e përfshira Ministria, Parlamenti, aktorët politikë opozitar, Presidenti duhet të jenë të karakterizuara nga vullneti për të bashkëpunuar, konsultimi dhe përfshirja e aktorëve të tjerë të shoqërisë, besimi dhe mirëkuptimi gjithashtu mesa aktorëve që mund të kenë dhe interesa të ndryshme mes tyre.

Pjesëmarrësit në Sesionin 2 të GP I:

Ekspert Sllovak: Jan Figel, ish Komisioner i BE dhe ish kryenegociator i Sllovakisë me BE

Ekspert Kombëtar GP IV: Evis Fico

Bashkëkryetarë: Adea Pirdeni, Zëvendës-Ministre e Drejtësisë; Gledis Gjipali, Lëvizja Europiane në Shqipëri

Institucionet shtetërore

Ministria e Drejtësisë: Etilda Gjona, Ministre e Drejtësisë; Enis Bregu; Artens Lazaj; Dudi Ilias; Elona Hoxha; Najada Shundi; Nino Strati; Stela Sulioti; Arnisa Tepelja; Argita Alikaj; Silvana Rusi

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme: Hektor Dodbiba;

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: Zana Josa; Ledia Dërmyshi;

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: Ilsa Dede; Ina Kokëdhima;

Ministria e Kulturës: Flutura Agaj;

Fondi Shqiptar i Zhvillimit: Mirbana Lame;

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: Blerina Kokaj;

Policia e Shtetit: Halil Miha

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave: Oligert Kume;

Shkolla e Drejtorëve: Geron Kamberi;

ATP: Rea Mucollari

ASHK: Alma Lundra;

Përfaqësi e huaj

Delegacioni i BE-së: Klaudijus Manjokas; Aurélien Juliard; Tidita Fshazi;

Ambasada e Austrisë: Christian Steiner, Ambassador; George Stawa;

Ambasada e Britanisë së Madhe: Jason Ivory, zv. Ambassador;

Ambasada e Holandës: Elga Mitre, Senior Political Officer; Hemion Braho

Ambasada e Italisë: Alberto Pentrageli;

Këshilli i Europës: Olsi Dekovi; Liljana Kaci;

EURALIUS: Agnes Bernhard

OSCE: Dorina Pashaj; Kimberly Schneider

Slovak Foreign Policy Association: Tomas Strazay;

GIZ Albania: Blerina Raca;

Shoqëria civile

Akademia e Integritit European dhe Negociatave: Mona Xhexhaj; Anita Lushi;

Lëvizja Europiane në Shqipëri: Nirvana Deliu; Endrita Shehu;

Klubi Ekologjik Elbasan: Ahmet Mehmeti;

Komiteti Shqiptar i Helsinkit: Jola Frashëri;

KAS: Zheni Korçari;

Instituti për Politika dhe Ligj: Florian Xhafa;

OSFA: Ersida Sefa;

Universitetet

Fakulteti i Drejtësisë; UT: Fjoralba Caka;

Universiteti Bujqësor i Tiranës: Kristaq Sini;

Epoka University: Artela Roshi;

Shkolla e Magjistraturës: Borana Mustafaraj;

Universiteti i Leiden: Darinka Piqani

Të tjerë

Evanthi Sulo; Bleona Sino; Iva Seseri; Dede Kasneci; Sokol Stojani; Sofjan Jaupaj; Etleva Haxhia; Sajmir Shehu; Granit Hoxha; Ermal Gucaj; Elda Zenelaj; Lucia Hanusinova; Denisa Varfi; Evgjëni Bashari; Koco Sokoli; Dhurata Kercani; Arvena Deda; Edmond Abdylly; Ariola Feraj; Elona Fana; Fatbardh Zenelaj; Irena Mitro; Albana Domi; Kujtim Luli; Rudina Konci; Marsida Grami; Glen Mebelli; Nina Keruti